REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.11.2022)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

1.1 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë.

1.2 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë.

1.3 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë.[1]

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:43 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***

[1] Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej si pikë e 9-të në rendin e ditës.

5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

4. Maela Alicanaj, Elisa Stamo, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

5. Valbona Bala, Eksperte (EwMI –INL).

6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Të tjerë: Katerina Çela, (Universiteti "Epoka"), Vladimir Karaj (BIRN).

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

1.Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

1.1 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë.

1.2 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë.

1.3 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 21 nëntor.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës kërkohet sot vendimmarrje për 13 çështje nga ana e Këshillit.

Pa humbur kohë po fillojmë me çështjen e parë e cila ka të bëjë me hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për tre pozicione të lira.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Toro, relatorin e projekt-aktit.

Alban Toro: Faleminderit!

Në lidhje me tre projektvendimet mbi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për një pozicion të lirë, më lejoni të relatoj si më poshtë:

Aktualisht, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ushtrojnë detyrën 6 (gjashtë) gjyqtarë me caktim të përhershëm. Pra, aktualisht, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka gjithsej 10 (dhjetë) pozicione të lira.

Vlen të përmendet se, aktualisht, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ushtrojnë detyrën edhe 3 (tre) gjyqtarë të tjerë , të caktuar për një periudhë 1-vjeçare nga skema e delegimit, duke bërë kështu që numri i gjyqtarëve që ushtrojnë aktualisht detyrën në këtë gjykatë të jetë 9 (nëntë).

Pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, marrë shkas nga pozicionet e lira të krijuara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke filluar nga data 26.02.2020 dhe deri më datë 06.07.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur dhe rihapur disa herë procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në këtë gjykatë, gjithsej për 10 (dhjetë) pozicione të lira. Për 3 (tre) nga pozicionet e lira, procedurat e ngritjes në detyrë ka përfunduar, duke u ngritur në detyrë kandidatët përkatës. Për 3 (tre) pozicione të tjera të lira, Këshilli është në proces e sipër të procedurave të ngritjes në detyrë, procedura në

të cilat kanë kandiduar gjithsej 3 (tre) kandidatë, nga 1 (një) kandidat në secilën procedurë, ku të 3 (tre) këta kandidatët janë gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë kësaj gjykate. Nga kandidatët në këto procedura, 2 (dy) nga ata janë kualifikuar për të vijuar procedurën e ngritjes në detyrë dhe për ata vazhdon procesi i vlerësimit etik dhe profesional, ndërsa për 1 (një) është në proces verifikimi të plotësimit të kushteve dhe kritereve ligjore të ngritjes në detyrë nga ana e Këshillit. Për 4 (katër) pozicione të tjera të lira, pavarësisht hapjes dhe rihapjes disa herë të procedurave të ngritjes në detyrë nga Këshilli, nuk ka pasur asnjë kandidat.

Nga ana e Këshilli, referuar procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ai ka operuar në vijimësi me rihapjen e disa pozicioneve të lira në kushtet e shfaqjes së një interesi të vogël nga ana e gjyqtarëve për ngritjen në detyrë në këtë gjykatë, si dhe numrit të kufizuar të kandidatëve potencial referuar numrit të gjyqtarëve të konfirmuar në detyrë në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Aktualisht, të konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit janë 96 gjyqtarë (pa përfshirë anëtarët e KLGJ), nga të cilët vetëm 39 janë gjyqtarë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, pra potencialisht të mundshëm për t'u ngritur në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Nga këta gjyqtarë, jo të gjithë plotësojnë kriteret për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërkohë që në këto momente numri i gjyqtarëve qe plotësojnë kriteret është 17 (shtatëmbëdhjetë) referuar listës që shoqëron listën e gjyqtareve për gjykim e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë të ndryshme nga ai ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

Na lejoni të theksojmë se duke vlerësuar rëndësinë e madhe që ka plotësimi i vendeve vakant të përhershme pranë kësaj gjykate, gjithashtu janë bërë përpjekjet nga ana e Këshillit dhe komisionit përkatës për plotësimin e tyre, pavarësisht se nuk ka pasur reagim nga gjyqtarët për të konkurruar.

Ndërkohë nga kjo gjykatë janë paraqitur për periudhën janar 2022 e në vijim 15 kërkesa për caktim gjyqtari në çështje të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksione në mënyrë të përhershme nga të cilat është plotësuar me 26 gjyqtar.

Informacioni për ngarkesën e çështjeve gjyqësore për çdo gjyqtar (145 çështje/gjyqtar) ju është paraqitur bashkëlidhur këtij relacioni.

Ndodhur në këtë situatë, ndërsa pozicionet e lira në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar mund të plotësohen vetëm përmes ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, ndërkohë që plotësimi i këtyre pozicioneve paraqet emergjencë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dhe i ripropozon Këshillit tre projektvendime për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjithsej për 3 (tre) pozicione të lira.

Projektvendimet janë bashkëlidhur këtij relacioni, dhe si afat ju propozohet afati i fundit për paraqitjen e dokumentacionit në kuadër të kandidimit është data 05.12.2022, pra është kjo datë që ju propozohet nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës si afat përfundimtar për paraqitjen e kandidimit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Toro!

Ftoj kolegët, nëse nuk kanë ndonjë diskutim, të votojmë lidhur me hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për tre pozicione.

T'i themi në mënyrë individuale vendime apo nuk ka nevojë?

Mund ta themi për tre pozicione? Meqë është e njëjta gjykatë, i njëjti profil.

Atëherë, edhe afati i kandidimit është deri më datë 05.12.2022.

Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për tre pozicione të lira.

Afati i kandidimit është deri më datë 05.12.2022.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.11.2022)

***Pika 2 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

2.1 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

2.2 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

2.3 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.[2]

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:43 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***

[2] Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej si pikë e 10-të në rendin e ditës.

5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

4. Maela Alicanaj, Elisa Stamo, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Të tjerë: Katerina Çela, (Universiteti "Epoka"), Vladimir Karaj (BIRN).

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

2.1 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

2.2 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

2.3 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër i cili ka të bëjë me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit në gjykatat e apelit respektive: në Gjykatën e Apelit Tiranë, në Gjykatën e Apelit Korçë dhe në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionet në fushën e së drejtës penale. Sërish relator është zoti Toro.

Alban Toro: Edhe në lidhje me tre projektvendimet për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë, Durrës, Korçë, po ju relatoj si më poshtë:

E fillojmë me situatën aktuale në Gjykatën e Apelit Tiranë e cila sipas Dekretit të Presidentit të Republikës nr.7818, datë 16.11.2012, ka përcaktuar një organikë prej 31 (tridhjetë e një) gjyqtarësh, numër ky i gjyqtarëve që vijon të jetë ende në fuqi ndërsa Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka marrë ende një vendim për numrin e gjyqtarëve në këtë gjykatë. Aktualisht në Gjykatën e Apelit Tiranë referuar organikës së përditësuar të datës 07.10.2022 vijon si më poshtë: Struktura organizative: 31 gjyqtarë; Organika në fakt: 23 gjyqtarë; Efektivisht në detyrë: 12 gjyqtarë.

Në relacion pasqyrohet në formë tabelare struktura organizative, numri i gjyqtarëve në fakt dhe ata efektivisht në detyrë.

Sa më sipër, Gjykata e Apelit Tiranë ka gjithsej 19 (nëntëmbëdhjetë) pozicione të lira, nga të cilat 11 (njëmbëdhjetë) të përkohshme (duke përfshirë anëtarin e KLGJ-së) dhe 8 (tetë) të përhershme.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, në ushtrim të përgjegjësive për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve, bazuar në nenin 48, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, në kushtet e nevojës emergjente të plotësimit të pozicioneve të lira me vendimet nr. 179 - 185, datë 28.05.2020 dhe me vendimet nr. 394 - 396, datë 07.10.2020, hapi të gjitha procedurat e mundshme për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, konkretisht 10 (dhjetë) procedura, nga të cilat 7 (shtatë) në fushën e të drejtës civile dhe 3 (tre) në fushën e të drejtës penale, pra gjithsej për dhjetë pozicione të lira. Aktualisht 7 (shtatë) procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë kanë përfunduar janë ende në proces dhe

3 (tre) procedura, konkretisht 2 (dy) procedura në fushën penale dhe 1 (një) në fushën civile.

Nisur nga sa sipër, mund të mendohet se në një kohë jo të largët, Gjykata e Apelit Tiranë do të plotësohet edhe me 3 (tre) gjyqtarë të tjerë, duke arritur kështu numri i gjyqtarëve të saj në detyrë në 15 (pesëmbëdhjetë) ose pak më shumë se 50% e numrit të përgjithshëm të tyre.

Siç u parashtrua, aktualisht në Gjykatën e Apelit Tiranë ka gjithsej 8 (tetë) pozicione të lira të përhershme, ku për plotësimin e 3 (tre) prej të cilave janë në proces procedurat përkatëse të ngritjes në detyrë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, sikurse edhe më parë, konsideruar edhe nga Këshilli, vlerëson se ato duhet të plotësohen përmes procedurave të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve. Zbatimi i alternativës tjetër të ligjit për plotësimin e pozicioneve të lira në këtë gjykatë, sikundër edhe në çdo gjykatë tjetër apeli, pra përmes procedurave të lëvizjes paralele, sikurse edhe më parë, por veçanërisht sot, nuk do të ishte në interesin më të mirë të publikut. Zbatimi i një procedure të tillë do të rriste numrin e gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Tiranë, por do të ulte këtë numër në gjykatat e tjera të apelit të cilat, pavarësisht zbatimit të skemës së delegimit nga Këshilli, janë tashmë në kushtet e funksionalitetit minimal apo gati minimal për të mos thënë bllokues. Gjykata e Apelit Korçë ka dy gjyqtarë; Gjykata e Apelit Vlorë ka dy gjyqtarë me caktim të përhershëm, pa përfshirë anëtaren e Këshillit, si edhe dy gjyqtarë të skemës së delegimit; Gjykata e Apelit Durrës ka tre gjyqtarë me caktim të përhershëm dhe një të skamës së delegimit; Gjykata e Apelit Gjirokastër ka dy gjyqtarë me caktim të përhershëm dhe një të skemës së delegimit; Gjykata e Apelit Shkodër ka katër gjyqtarë të caktuar në mënyrë të përhershme dhe një nga skema e delegimit. Ndaj, zbatimi i procedurës së lëvizjes paralele vetëm do të përkeqësonte me tej funksionalitetin e tyre, ndërsa mund të supozohet edhe humbja e tij për ndonjë gjykatë, çka nuk do t'i shërbente interesit publik, interes nga i cili Këshilli duhet të udhëhiqet në çdo rast. Nga ana tjetër, plotësimi në kohë i pozicioneve të lira në gjykatat e tjera të apelit duket praktikisht i pamundur ose shumë i vështirë. Kështu, zbatimi i procedurave të lëvizjes paralele për plotësimin e pozicioneve të lira në Gjykatën e Apelit Tiranë, përveç se i padobishëm në pikëpamje të ruajtjes së funksionalitetit të gjykatave të apelit në përgjithësi, mund të

rezultojë e padobishme edhe për vetë këtë gjykatë në supozimin që riorganizimi i ri gjyqësor, proces që pritet të hyjë në fuqi më datë 1 shkurt 2022. Nën këtë supozim, zbatimi i procedurave të lëvizjes paralele do të rezultonte vetëm një humbje kohe e padobishme. Edhe miratimi i hartës gjyqësore me vendimit nr. 495, datë 21.07.2022 të Këshillit të Ministrave nuk cenon numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve në fuqi për gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, madje pritshmëria është rritja e numrit të gjyqtarëve në hipotezën e financimit nga ana e Kuvendit me buxhet për krijimin e ambienteve të përshtatshme për të punuar.

Lidhur me nevojën e hapjes së 1 (një) procedure të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, përveç situatës aktuale dhe atë të pritshme në këtë gjykatë, nivelit të lartë të numrit të çështjeve që kjo gjykatë gjykon, vlerësoi edhe dakordësinë e shprehur nga shumica e anëtarëve në Këshill.

Ndaj, sa më lart, Komisioni vlerëson se fillimi aktualisht i një procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke mbajtur parasysh dhe kohën që këto procedura kanë marrë deri më sot, më së paku 6 (gjashtë) muaj, do të mundësonte plotësimin e 1 (një) pozicioni të lirë në një kohë më të shpejtë, duke rritur në këtë mënyrë funksionalitetin e saj, ndërkohë që stoku i çështjeve për gjykim përpara kësaj gjykate aktualisht, më datë 10.10.2022, është 19.736 çështje, e tillë që dëmton të drejtën e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

Siç është e njohur, procesi i riorganizimit të ri gjyqësor është në fazën e ndjekjes dhe zbatimit të vendimit nr. 495, datë 21.07.2022 të Këshillit të Ministrave. Ndërkohë, riorganizimi gjyqësor patjetër do të shoqërohet edhe me caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë, përfshirë edhe në ato të apelit. Ndaj një rrethanë e tillë është dhe duhet konsideruar si një faktor që duhet mbajtur parasysh nga Këshilli në një kohë sa më të shpejtë, marrë në konsideratë procedurat që duhet për të zhvilluar plotësimin e pozicioneve të lira si edhe tendencën në rritje të gjykimeve në gjykatën e apelit dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve në të.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se çdo skenar i riorganizimit të ri gjyqësor nuk impakton konkluzionin më lart, pra atë të nevojës së hapjes minimale të 1 (një) procedure të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Situata aktuale në Gjykatën e Apelit Durrës - Sipas Dekretit të Presidentit të Republikës nr.7818, datë 16.11.2012, i ndryshuar, organika e Gjykatës së Apelit Durrës është 13 (trembëdhjetë) gjyqtarë, numër ky i gjyqtarëve që vijon të jetë ende në fuqi ndërsa Këshilli i Lartë Gjyqësor ende nuk ka marrë një vendim për numrin e gjyqtarëve për gjykatë.

Aktualisht në Gjykatën e Apelit Durrës referuar organikës së përditësuar vijon si më poshtë: Struktura organizative: 13 gjyqtarë; Organika në fakt: 6 gjyqtarë; Efektivisht në detyrë: 5 gjyqtarë.

Në formë tabelare ju është paraqitur ky fakt në këtë relacion.

Sa më lart, aktualisht, Gjykata e Apelit Durrës ka gjithsej 10 (dhjetë) pozicione të lira, nga të cilat 5 (pesë) të përkohshme dhe 5 (pesë) të përhershme.

Situata e procedurave të hapura për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe nevoja për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë - Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve, bazuar në nenin 48, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, në kushtet e nevojës emergjente të plotësimit të pozicioneve të lira, me vendimet nr.129, datë 01.04.2021 dhe 392, datë 07.10.2020, hapi procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për dy pozicione (1 civil dhe 1 penal), në kushtet kur një nga këto procedura nuk është përmbyllur ende konkretisht pozicioni me vendimin nr.129, datë 01.04.2021, vijon të ekzistojë e njëjta situatë emergjente për plotësimin e vakancave në këtë gjykatë, ndërsa janë krijuar dhe vakanca të reja të përhershme, por edhe vakanca të përkohshme, si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar.

Vlen të përmendet se në Gjykatën e Apelit Durrës aktualisht janë në detyrë vetëm pesë gjyqtarë, nga trembëdhjetë të tillë sipas organikës së kësaj gjykate. Tre nga gjyqtarët e kësaj gjykate janë shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe janë pezulluar nga detyra për shkak të Ligjit nr.84/2016, duke qenë pozicionet e mbajtura nga ata përkohësisht të lira. Dy gjyqtarë të kësaj gjykate janë gjyqtarë të skemës së delegimit ku së fundmi dhe në kohë të shpejtë ekziston pritshmëria që gjyqtarët të përfundojnë

procedurën e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke pakësuar numrin e gjyqtarëve pranë kësaj gjykate.

Ngarkesa e çështjeve për gjyqtar sipas kësaj gjykate ju paraqitet në formë tabelare bashkëlidhur këtij relacioni dhe shkon diku tek 2993 çështje në total.

Ndërkohë janë paraqitur nga kjo gjykatë për periudhën janar 2022 e në vijim 20 kërkesa për caktim gjyqtari në çështje të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme nga të cilat është plotësuar me 20 gjyqtarë.

Lidhur me nevojën e hapjes së 1 (një) procedure të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, përveç situatës aktuale dhe atë të pritshmërisë në këtë gjykatë, ka në konsideratë dhe riorganizimin që do të kryhet në bazë të hartës së re gjyqësore si pasojë e zbatimit të vendimit nr. 495, datë 21.07.2022 të Këshillit të Ministrave dhe moscenimit të numrit të përgjithshëm në fuqi për gjyqtarët e apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Dukshëm, me hapjen e këtij pozicioni, ekuilibri midis interesit publik të realizimit të gjykimeve brenda një afati të arsyeshëm, uljes së ngarkesës së gjyqtarëve dhe riorganizimit të hartës gjyqësore është optimal, jo vetëm në momentin e realizimit por edhe në të ardhmen.

Ndaj sa më lart, Komisioni vlerëson se fillimi aktualisht i një procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, duke mbajtur parasysh dhe kohën që këto procedura kanë marrë deri më sot, më së paku 6 (gjashtë) muaj, do të mundësonte plotësimin e 1 (një) pozicioni të lirë në një kohë më të shpejtë, duke rritur në këtë mënyrë funksionalitetin e saj.

Situata aktuale në Gjykatën e Apelit Korçë – Sipas Dekretit të Presidentit të Republikës nr.7818, datë 16.11.2012, i ndryshuar, organika e Gjykatës së Apelit Korçë është 6 (gjashtë) gjyqtarë, numër ky i gjyqtarëve që vijon të jetë ende në fuqi ndërsa Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka marrë ende një vendim për rritjen e numrit.

Aktualisht në Gjykatën e Apelit Korçë referuar organikës së përditësuar vijon si më poshtë: Struktura organizative: 6 gjyqtarë; Organika në fakt: 4 gjyqtarë; Efektivisht në detyrë: 2 gjyqtarë.

Në formë tabelare është bashkëlidhur këtij relacioni edhe ky informacion.

Sa më lart, aktualisht, Gjykata e Apelit Korçë ka gjithsej 4 (katër) pozicione të lira, nga të cilat 2 (dy) të përkohshme dhe 2 (dy) të përhershme.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, në kushtet e nevojës emergjente të plotësimit të pozicioneve të lira, me vendimet nr. 176, datë 28.05.2020 dhe nr. 132, datë 01.04.2021, hapi procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për dy pozicione (1 civil dhe 1 penal), në kushtet kur të dyja këto procedura janë përmbyllur, vijon të ekzistojë e njëjta situatë emergjente për plotësimin e vakancave në këtë gjykatë.

Vlen të përmendet se në Gjykatën e Apelit Korçë aktualisht janë në detyrë vetëm dy gjyqtarë, nga gjashtë të tillë sipas organikës së kësaj gjykate. Dy nga gjyqtarët e kësaj gjykate janë shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe janë pezulluar nga detyra për shkak të Ligjit nr.84/2016, duke qenë pozicionet e mbajtura nga ata përkohësisht të lira. Një gjyqtare e kësaj gjykate është gjyqtare e skemës së delegimit dhe më datë 15.10.20022 ka përfituar nga e drejta për leje të paralindjes. Në këtë kuadër funksionaliteti i Gjykatës së Apelit Korçë rezulton të jetë i kompromentuar duke kërkuar ndërhyrje urgjente për zëvendësimin e saj.

Aktualisht, ngarkesa e çështjeve gjyqësore në këtë gjykatë paraqitet në formë tabelare ashtu siç është paraqitur në relacion, me një total prej 856 çështjesh.

Ndërkohë nga kjo gjykatë janë paraqitur për periudhën janar 2022 e në vijim, 59 kërkesa për caktim gjyqtari në çështje të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksione në mënyrë të përhershme nga të cilat është plotësuar në total me 95 gjyqtarë.

Lidhur me nevojën e hapjes së 1 (një) procedure të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, përveç situatës aktuale dhe atë të pritshme në këtë gjykatë, ka në konsideratë edhe se, marrë shkas nga tendenca e derisotme e rezultateve të procesit të rivlerësimit kalimtar, pa dashur dhe aq më tepër pa pasur mundësinë e vlerësimit të rasteve individuale, situata e pritshme në këtë gjykatë pare në këtë aspekt, nuk duket pozitive, pra mund të mos ketë përmirësim ose ky përmirësim të jetë relativ, jo domethënës.

Ndaj sa më lart, Komisioni vlerëson se fillimi aktualisht i një procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçës duke mbajtur parasysh dhe kohën, ndoshta do të mundësonte plotësimin e 1 (një) pozicioni të lirë në një kohë më të shpejtë, duke rritur në këtë mënyrë funksionalitetin e saj.

Në këtë kuadër, janë përgatitur tre projektvendimet, duke ju propozuar përfundimisht edhe afatin, data 5, për paraqitjen e kandidaturave në kuadër të konkurrimit për këto pozicione. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktet e relatuara nga zoti Toro, atëherë kalojmë në votim projekt-aktin e parë, i cili ka të bëjë me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale. Afati i kandidimit është deri më datë 05.12.2022. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale, me afat kandidimi deri më datë 05.12.2022.

Naureda Llagami: Projekt-akti i dytë, ka të bëjë me hapjen e procedurës për ngritjen në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Hapjen e procedurës për ngritjen në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale, me afat kandidimi deri më datë 05.12.2022.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale. Afati i kandidimit është deri më datë 05.12.2022.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.11.2022)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm" i përgatitur nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z.Ilir Rusi, znj.Brikena Ukperaj dhe znj.Marçela Shehu.[3]

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:43 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***

[3] Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej si pikë e parë në rendin e ditës.

9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

4. Maela Alicanaj, Elisa Stamo, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Të tjerë: Katerina Çela, (Universiteti "Epoka"), Vladimir Karaj (BIRN).

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm" i përgatitur nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z.Ilir Rusi, znj.Brikena Ukperaj dhe znj.Marçela Shehu.

Naureda Llagami: Kalojmë tek akti i radhës i cili në fakt është një akt mjaft i rëndësishëm për të cilin Këshilli i Lartë Gjyqësor po merr hapat e mëtejshëm. Është një nga hapat e mëtejshme që po marrim mbi zbatimin e projektit të hartës së re gjyqësore.

Siç jeni në dijeni, thjesht për t'ju informuar, me miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për hartën e re gjyqësore është ngritur një Grup Ndërinstitucional i Punës i cili ka përgjegjësinë dhe detyrën për të hartuar të gjithë aktet nënligjore dhe për të bërë të mundur funksionimin pa vonesë të zbatimit të hartës së re gjyqësore. Kështu që në radhë të parë përgëzoj grupin e punës për punën që ka bërë lidhur me përcjelljen përpara

Këshillit të aktit të parë, i cili do jetë besoj akti i parë dhe që me të do vijnë edhe aktet e tjera që do të mundësojnë bërjen funksionale të hartës së re gjyqësore, zbatimi i së cilës fillon më datë 1 shkurt 2023.

Pa humbur kohë, fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Bashkëngjitur aktit për projektvendimin e titulluar "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", nga ana e tre anëtarëve të Këshillit, prej meje, zonjës Shehu dhe zotit Rusi, si anëtarë të grupit të punës për zbatimin e hartës së re gjyqësore është përpiluar edhe relacioni përkatës. Bashkë me këtë relacion janë përcjellë edhe plani i punës që grupi i punës ka miratuar në kuadër të fillimit të zbatimit të hartës së re gjyqësore, ku gjenden të detajuara dhe të specifikuara të gjitha aktet nënligjore por edhe veprimet që Këshilli duhet të ndërmarrë, me qëllim që në datën 1 shkurt 2023 të fillojë funksionimi i Gjykatës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm.

Nga shkurti i vitit 2019, Këshilli është angazhuar në një proces gjithëpërfshirës të vlerësimit të organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave, në zbatim të neneve 13 dhe 15 të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". Ky proces evidentoi problematika në drejtim të: shpërndarjes së pabarabartë të ngarkesës midis gjyqtarëve, volumit të çështjeve të prapambetura ose backlog-ut të krijuar, moshës së shqyrtimit të çështjeve me diferenca të konsiderueshme në 6 gjykatat aktuale të apeleve, prurjeve të çështjeve të reja në gjykatat e apeleve dhe numrit efektivisht të gjyqtarëve në detyrë, për të cilët palëvizshmëria ishte kthyer në përjashtim, e lëvizshmëria për të gjykuar nga një gjykatë në tjetrën, përbënte tashmë një rregull të diktuar nga nevojat. Gjetjet e mësipërme, të shoqëruara me një analizë të hollësishme të të dhënave statistikore, të kryer nga ekspertë ndërkombëtarë, konfirmuan se harta gjyqësore në fuqi nuk i përmbushte kërkesat ligjore, jo vetëm për gjykatat e shkallës së parë, por edhe për gjykatat e apeleve.

Pas një procesi bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë e më gjerë, si dhe pas konsultimit me grupet e interesit, propozimi i përbashkët i Këshillit dhe Ministrisë së Drejtësisë, i titulluar "Për riorganizimin e

rretheve gjyqësore dhe kompetencave të gjykatave" u miratua me vendimin nr. 495, datë 21.7.2022 të Këshillit të Ministrave, i botuar në fletoren zyrtare nr. 107, të datës 21.07.2022. Ky propozim parashikon, midis të tjerash, riorganizimin e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm në një Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm, që organizohet dhe funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë, e cila fillon funksionimin në datën 1 shkurt 2023.

Për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj VKM-je, me urdhrin nr.80, datë 27.07.2022 të Kryetares së Këshillit është ngritur dhe po funksionon një Grup Ndërinstitucional Pune, (në vijim GNP), i cili ka në përbërje përfaqësues të Këshillit (anëtarë dhe drejtues të lartë të administratës), gjyqtarë të gjykatave të apeleve dhe kancelarë, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe të projekteve të mbështetjes teknike që e kanë shoqëruar Këshillin gjatë gjithë këtij procesi, si Projekti i zbatuar nga Instituti i Menaxhimit Lindje – Perëndim (EWMI-INL) dhe Këshilli i Evropës. Detyra e këtij grupi pune është ndërtimi i një plani të detajuar e funksional të zbatimit të hartës së re gjyqësore, me shtylla kryesore të punës: burimet njerëzore, administrimi gjyqësor, administrata gjyqësore, godinat dhe infrastruktura, teknologjia e informacionit, administrimi i çështjeve, përgjegjësitë buxhetore e detyrimet financiare si dhe jo më pak i rëndësishëm, informimi i publikut.

Ky plan i detajuar pune i miratuar nga vetë grupi i punës, kërkon angazhimin e mbledhjes plenare për miratimin e një sërë aktesh nënligjore, me karakter normativ apo kolektiv sipas rastit, si dhe kryerjen e një sërë veprimesh nga administrata e Këshillit në bashkëpunim me gjykatat, me qëllim sigurimin e funksionimit normal të punës në 1 shkurt 2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Projekt-akti "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm" i paraqitet për miratim mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në zbatim të detyrimeve kushtetuese e ligjore të këtij Këshilli, për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, veçanërisht në drejtim të ofrimit të shërbimeve cilësore dhe në kohë nga gjykatat e apelit, të cilat do t'i nënshtrohen procesit të riorganizimit të kompetencave tokësore.

Akti që i paraqitet për miratim Këshillit është një akt normativ nënligjor, i cili është i harmonizuar me misionin, vizionin dhe vlerat thelbësore të pushtetit gjyqësor, si dhe Objektivin Strategjik 3 të Planit Strategjik të Këshillit 2022-2024, që synon përmirësimin e ofrimit të shërbimeve efikase përmes miratimit dhe zbatimit të hartës së re gjyqësore, novacionit dhe forcimit të strukturave dhe sistemeve të teknologjisë që garantojnë koherencën, efikasitetin dhe efektshmërinë e gjykatave.

Ky projektvendim është konceptuar si një vendim kuadër që përcakton tërësinë e parimeve që do të udhëheqin procesin e zbatimit të riorganizimit të kompetencave tokësore të gjykatave të apelit, duke synuar vijimësinë në drejtimin dhe ofrimin e shërbimeve gjyqësore, administrative dhe atyre mbështetëse nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në datën 1 shkurt 2023.

Parimi kryesor mbi të cilin bazohet përmbajtja e këtij projekt-akti është ai i "gjykatave të riorganizuara" dhe jo ai i krijimit të një "gjykate të re". Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, gjykatat krijohen vetëm me ligj. VKM-ja në rastin konkret riorganizon kompetencat tokësore të gjykatave në mënyrë të tillë që kompetencat aktuale tokësore të gjykatës së apelit Tiranë zgjerohen dhe shtrihen tashmë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Pesë gjykatat e apeleve të rretheve, pushojnë së funksionuari pas datës 1 shkurt 2023, kompetencat tokësore të të cilave janë përthithur nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Riorganizimi i kompetencave tokësore të gjykatave në një gjykatë të vetme apeli të juridiksionit të përgjithshëm, passjell mbarimin e ekzistencës si persona juridikë të 5 gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm. Fillimi i funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm kërkon vendimmarrjen e Këshillit në shumë drejtime si: sistemimi në pozicione i gjyqtarëve të gjykatave të apeleve, i punonjësve që ofrojnë shërbime administrative e mbështetëse në këto gjykata, transferimi i çështjeve e dosjeve gjyqësore, funksionimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe regjistrimit audio të seancave gjyqësore, infrastruktura e teknologjisë së informacionit dhe ajo fizike e godinave, komunikimi me publikun dhe përdoruesit e gjykatave etj.

Të gjitha dispozitat e këtij projektvendimi janë hartuar në frymën dhe përçojnë të njëjtin parim, atë të "gjykatës së riorganizuar", e cila vijon rregullisht ushtrimin e

veprimtarisë gjyqësore e administrative të të gjitha gjykatave të apelit pas datës 01.02.2023 me emërtimin "Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm".

Parimet bazë mbi të cilat është hartuar ky projekt-akt përfshijnë garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit qytetarëve dhe përdoruesve të gjykatës në një gjykatë tërësisht funksionale në datën 1 shkurt 2023, parimin e efikasitetit në trajtimin e procesit të riorganizimit, mbajtjen në konsideratë të kapaciteteve njerëzore dhe profesionale të gjykatave, përmbylljen e procesit të riorganizimit brenda afatit të caktuar dhe me transparencë.

Projektvendimi është hartuar duke marrë në konsideratë standardet më të mira ndërkombëtare të cilat kanë udhëhequr procesin e vlerësimit dhe përgatitjes së hartës se re gjyqësore, që synojnë të garantojnë vijimësinë në ofrimin e shërbimeve, specializimin, racionalizimin e shpenzimeve publike. Më konkretisht kanë qenë opinionet, rekomandimet dhe studimet e CEPEJ që ofrojnë ekuilibër midis parimeve ndërkombëtare të mirëpranuara si: a) aksesi në drejtësi; b) efikasiteti dhe efiçenca e sistemit gjyqësor dhe c) cilësia e shërbimeve gjyqësore.

Projektvendimi është një produkt i dakordësuar në mbledhje nga të gjithë anëtarët e grupit nërinstitucional të punës, përfaqësues të të gjitha institucioneve brenda e jashtë sistemit gjyqësor që ndikohen nga zbatimi i hartës së re gjyqësore. Në këtë relacion shpjegues parashtrohen dhe argumentohen zgjidhjet e propozuara, mbi parimet mbështetëse të sipërpërmendura për zbatimin efektiv të kësaj harte.

Akti i propozuar për miratim reflekton tërësinë e masave që duhen marrë paraprakisht me qëllim që konfigurimi i ri i propozuar të garantojë vazhdimësinë dhe funksionalitetin e pandërprerë të shërbimeve në gjykatë. Në të njëjtën kohë ky akt i shërben përmbushjes së nevojës për rritjen e efiçencës së shërbimeve gjyqësore dhe shpërndarjes në mënyrë proporcionale të ngarkesës së punës midis të gjithë gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Konceptimi i këtij akti si vendim kuadër synon pasjen e një vendimi që orienton qartë dhe shërben si udhërrëfyes për hapat e tjera të punës për riorganizimin e gjykatave sipas fazave të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave. Në të njëjtën kohë, pas miratimit ky vendim, i hap rrugë miratimit të akteve të tjera të nevojshme që do të

bëjnë të mundur vijimin e funksionalitetit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, sistemimin e administratës gjyqësore të gjykatave të Apelit Durrës, Gjirokastër, Korçë, Vlorë dhe Shkodër përmes ngritjes dhe funksionimit të Komisionit të Ristrukturimit, apo miratimit të rregullave standarde dhe organikës së gjykatës, miratimit të rregullave të administrimit të çështjeve gjyqësore, etj. Veçanërisht për çështje që lidhen me Teknologjinë e Informacionit, vendimi kuadër përcakton shprehimisht përgjegjësinë e Drejtorisë së Administrimit Gjyqësor dhe të Teknologjisë së Informacionit në Këshill për të ndjekur me prioritet procesin e harmonizimit të kërkesave ligjore e procedurale me elementet teknike të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore me qëllim garantimin e funksionalitetit të plotë të tij.

Vendimi kuadër është ndarë në 6 seksione dhe 9 nene në tërësi.

Seksioni I dhe neni 1 parashikojnë emërtimin dhe selinë e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, datën e fillimit të funksionimit në 1.02.2023, si dhe afatin kohor fundor kur Gjykatat e Apelit Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, ndërpresin veprimtarinë e tyre, duke parashikuar datën 31.01.2023. Kjo e fundit përbën edhe datën e pushimit së ekzistuari si persona juridikë të gjykatave të apelit Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë. Gjykata e Apelit Tiranë, si person juridik, përbën "gjykatën mëmë" kompetencat tokësorë të së cilës tashmë përfshijnë të gjithë Republikën e Shqipërisë. Kjo gjykatë ndryshon emërtimin e saj nga "Gjykata e Apelit Tiranë" në "Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm". Parimi i "Riorganizimit të kompetencave tokësore, por jo krijimit të Gjykatës së re", pasqyrohet në këtë nen, duke bërë dallimin midis procesit të riorganizimit të ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore nga 6 gjykata apeli në një gjykatë apeli, nga procesi i bashkimit të 5 gjykatave si persona juridikë (gjykata bija) me gjykatën e apelit Tiranë (gjykatë mëmë), nën një emërtim të ri Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në kuadër të vijimit të ushtrimit të veprimtarisë, vlen të theksohet që Gjykata e Apelit Tiranë veç ndryshimit të emërtimit të saj, nuk është e nevojshme të pajiset me numër unik tjetër identifikimi, sepse nuk përbën person juridik të ri, por të riorganizuar nga bashkimi me të, i 5 personave juridikë, gjykatat "bija" të apelit Korçë, Durrës, Gjirokastër, Shkodër e Vlorë.

Bazuar në parimet e këtij neni, 5 personat juridikë, gjykatat “bija” të apelit Korçë, Durrës, Gjirokastër, Shkodër e Vlorë, me mbarimin e tyre ne dt. 31.01.2023, humbasin personalitetin e tyre juridik. E njëjta gjë nuk vlen për Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila vijon të gëzojë të njëjtin personalitet juridik, edhe pas bashkimit, duke u ndryshuar vetëm emërtimi.

Seksioni II dhe neni 2 trajtojnë çështje që lidhen me organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Konkretisht në lidhje me gjyqtarët e kësaj gjykate, vendimi nuk ka të përcaktuar numër konkret, duke parashikuar nevojën e nxjerrjes së një akti të veçantë të Këshillit, me qëllim që në eventualitetin e ndryshimit të këtij numri në të ardhmen, të mos jetë e nevojshme ndryshimi i përmbajtjes së këtij vendimi kuadër.

Parashikimet e këtij neni janë reflektim i parimeve kushtetuese të palëvizshmërisë dhe vijimësisë në ushtrimin e detyrës të gjyqtarëve të cilët janë emëruar apo caktuar në pozicione të përhershme në gjykatat e apelit, sipas parashikimeve të neneve 42 pika 3 shkronja “b” dhe 44 pika 1 shkronja “a” të ligjit 96/2016 “Për statusin”, i ndryshuar. Për gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, vendimi parashikon qëndrimin në pozicione të përhershme në strukturën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Vijimësia në ushtrimin e funksionit për gjyqtarët e gjykatave të tjera të apeleve, të cilëve u suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit, sigurohet përmes transferimit të tyre në strukturën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Nevoja e plotësimit të vendeve vakante mbetet evidente, prandaj për të siguruar këtë të fundit si dhe sigurinë juridike mbi pritshmërinë e ngritjes në karrierë nga gjyqtarët që kanë tashmë aplikuar për këto pozicione, duke përshirë edhe gjyqtarë që do aplikojnë në kuadër të këtyre tre pozicioneve që Këshilli tashmë rishpalli, vendimi kuadër shpreh edhe njëherë angazhimin e Këshillit për të vijuar procedurat aktuale të ngritjes në detyrë të shpallura në disa gjykata të apeleve, për llogari të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Kështu vendimi parashikon se pozicionet e shpallura për ngritje në detyrë në të gjitha gjykatat e apelit, për të cilat procedura nuk ka përfunduar ende në datë 01.02.2023, konsiderohen pozicione të lira të përhershme të Gjykatës së Apelit të

Juridiksionit të Përgjithshëm, duke garantuar vijimin e procedurave për ngritjen në detyrë të shpallura më parë nga Këshilli në të gjitha gjykatat e apeleve.

Seksioni 3 dhe neni 3, trajton çështje që lidhen me organet e administrimit gjyqësor. Vendimi konfirmon edhe njëherë parime të parashikuara nga ligji "Për statusin", i ndryshuar dhe ligji "Për organizimin e pushtetit gjyqësor", ndër të cilat është edhe parimi i zëvendësimit të kryetarit nga zëvendëskryetari në rastet kur kryetari mungon.

Vendimi synon gjithashtu të sigurojë një qasje të kombinuar duke garantuar jo vetëm vijimësinë në ushtrimin e detyrës sipas mandatit, por edhe përfaqësimin për aq sa është e mundur të trupës gjyqësore në Këshillin e Gjykatës. Kështu në vijim të parimeve të mësipërme, vendimi parashikon se zëvendëskryetari i Gjykatës së Apelit Tiranë, qëndron në detyrën e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm deri në përfundim të mandatit, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, sipas ligjit.

Vijimësia parashikohet edhe për kancelarin në detyrë të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili qëndron në detyrën e kancelarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm deri në emërimin e kancelarit të ri të kësaj gjykate sipas nenit 83 të ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor". Ndërsa kancelarët e gjykatave të tjera të apelit, duke qenë pjesë e administratës gjyqësore të gjykatave që mbarojnë funksionin, do t'i nënshtrohen procesit të ristrukturimit, për shkak të suprimimit të pozicionit, sipas parashikimeve të mëposhtme në projekt-akt.

Këshilli i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, deri në zgjedhjen e kryetarit dhe emërimin e kancelarit, përbëhet nga zëvendëskryetari, kancelari në detyrë dhe gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar në datën e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 71, datë 20.05.2019 "Për procedurën e funksionimit të Këshillit të Gjykatës".

Seksioni IV, nenet 4 dhe 5 vendosin rregulla për administrimin e brendshëm gjyqësor, duke synuar vijimin e ofrimit të shërbimeve gjyqësore, administrative dhe mbështetëse.

Neni 4 merr në konsideratë parashikimet ligjore të nenit 66, pika 6 e ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", duke evidentuar nevojën për miratimin e disa akteve të veçanta që detajojnë respektivisht rregullat për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit dhe rregullat standarde për strukturën dhe organikën e administratës gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Duke synuar garantimin e funksionalitet, në mungesë të krijimit të një gjykate të re, mbështetur në parimet e mësipërme, në nenin 4 të projekt-aktit është parashikuar se administrata gjyqësore e Gjykatës së Apelit Tiranë, e përbërë nga punonjësit e konfirmuar tashmë në detyrë nga Këshilli i Gjykatës, që ushtrojnë shërbimet gjyqësore, administrative dhe ato mbështetëse sipas përcaktimeve të ligjit, vijon të ushtrojë veprimtarinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe nuk i nënshtrohen procesit të ristrukturimit. Ndërsa administrata gjyqësore e personave juridikë që mbarojnë për shkak të ndërprerjes së ushtrimit të funksionit, në gjykatat e tjera të apelit, i nënshtrohet procesit të ristrukturimit, pasi pozicionet e tyre suprimohen.

Procesi i ristrukturimit i hap rrugë sistemimit të të gjithë punonjësve të gjykatave të apelit Durrës, Vlorë, Gjirokastër, Shkodër e Korçë, në pozicionet e strukturës së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ose në gjykatat e tjera në rast se do të jetë e nevojshme. Grupi i punës është udhëhequr nga parimi i cituar që në momentin e përgatitjes së projektit për hartën, për sistemimin në pozicione në gjykata, të të gjithë personelit të gjykatave të apeleve që si persona juridikë i bashkohen nën një emërtim të ri Gjykatës së Apelit Tiranë. Krijimi dhe funksionimi i Komisionit të Ristrukturimit do të miratohet me një akt të veçantë të Këshillit, mbi bazën e parimeve të përcaktuara pikërisht në nenin 4 të këtij projekt-akti. Drafti përkatës është duke u përfunduar nga grupi i punës sikundër edhe rregullat e brendshme të gjykatave që përcaktojnë rregulla standarde për strukturën, përshkrimet e punës dhe organigramën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, bashkë me aktet që lidhen për numrin e organikave të gjykatave respektive.

Neni 5 trajton në thelb rregullat që do të ndiqen për vijimin e funksioneve të Njësisë së Shërbimit Ligjor, duke parashikuar qëndrimin në detyrë të ndihmësve

ligjorë të Apelit Tiranë dhe transferimin e përhershëm të ndihmësve ligjorë, të cilëve u suprimohet pozicioni për shkak të bashkimit të gjykatave të tjera të apelit me gjykatën e Apelit Tiranë, me emërtimin e ri Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në pozicione në strukturën e kësaj të fundit.

Seksioni V, nenet 6 dhe 7 përcaktojnë parimet e transferimit dhe menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Konkretisht neni 6 parashikon se të gjitha çështjet gjyqësore të regjistruara në në të gjitha gjykatat e apelit deri në datën 31.01.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen si çështje të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Çështjet gjyqësore që transferohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS. Vendimi ngarkon shprehimisht Departamentin e Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit për të ndjekur procesin e transferimit dhe regjistrimit të tyre manualisht apo elektronikisht. Ky parim nuk është shmangie nga parimi i mësipërm i "gjykatës së riorganizuar" dhe "gjykatës së re", përkundrazi mundëson një nga qëllimet e hartës për evidentimin dhe regjistrimin e të gjitha çështjeve të regjistruara në gjykatat e apeleve sipas moshës e kategorisë, si çështje tashmë të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në lidhje me menaxhimin e çështjeve gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, vendimi parashikon se ato rindahen me short elektronik, në përputhje me kriteret e miratuara nga Këshilli. Ky akt është në proces përgatitje përsëri nga grupi i punës dhe do t'i paraqitet së shpejti për miratim mbledhjes plenare.

Projektvendimi ka përjashtuar nga rindarja me short çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të cilat ka filluar apo është planifikuar shqyrtimi gjyqësor në gjykatat e apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, pasi këto çështje do të vijojnë të shqyrtohen nga të njëjtët gjyqtarë dhe në fazën në të cilën ato ndodhen, për llogari të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në përputhje edhe me konkluzionet e Vendimit Njehsues të Gjykatës së Lartë nr. 13, datë 04.04.2018.

Për efekt të riorganizimit, transferimit, menaxhimit dhe ndërhyrjeve në Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve, planifikimi i datave për gjykimin e çështjeve gjyqësore në gjykatat e apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastër, Shkodër, Korçë dhe Vlorë, duhet të bëhet deri në 31.12.2022. Ky rregull nuk gjen zbatim për çështjet urgjente sipas ligjit.

Seksioni VI neni 8, parashikon parimin e marrjes së përgjegjësive buxhetore dhe financiare nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për shkak të mbarimit si persona juridikë të gjykatave të apeleve Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastër.
Neni 9 parashikon rregullin e hyrjes në fuqi nisur nga natyra e aktit si akt normativ nënligjor.

Lidhur me zbatimin e këtij akti.

Zbatimi i aktit kuadër kërkon qasje proaktive nga të gjitha gjykatat, si organet drejtuese ashtu edhe administrata gjyqësore e tyre, për të bashkëpunuar ngushtësisht me Këshillin e Lartë Gjyqësor e për të siguruar vijimësi në ofrimin e shërbimeve, drejtësi efektive dhe në kohë për qytetarët.

Lidhur me efektet financiare të aktit.

Ky akt nuk krijon drejtpërdrejt efekte të tjera financiare për hartën e re gjyqësore, veç atyre të parashikuara më parë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Bashkëngjitur relacionit i cili është relacion i përgatitur nga të tre anëtarët e grupit të punës janë edhe materialet e marra deri tani në shqyrtim nga grupi i punës për zbatimin e hartës.

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Ukperaj!

Atëherë, ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit i cili është projekt-akti kuadër për aktet e tjera për zbatim.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Miratimin e vendimit "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", sipas propozimit të ardhur nga Grupi Ndërinstitucional i Punës mbi zbatimin e hartimit së re gjyqësore.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.11.2022)

***Pika 4 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).[4]

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:43 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***

[4] Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej si pikë e dytë në rendin e ditës.

7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

4. Maela Alicanaj, Elisa Stamo, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Të tjerë: Katerina Çela, (Universiteti "Epoka"), Vladimir Karaj (BIRN).

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë

në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit". Relator është zoti Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Atëherë, kemi bërë verifikimet për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kritereve ligjore të kandidimit në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatit {...}. Kemi bërë verifikimet për tre kriteret. Iu dërguan formularët. Ka plotësuar të gjitha formularët përkatëse dhe në verifikime ka rezultuar se:

I referohemi përvojës profesionale që në kriteret ligjore është 13 vjet të paktën si përvojë profesionale në ushtrimin e profesionit dhe jo më pak se 5 vjet në pozicionin përkatës ku ka aplikuar kandidati.

Ka rezultuar se kandidati për Gjykatën e Lartë ka mbaruar Fakultetin e Drejtësisë dhe ka marrë titullin "Jurist" më datë 25.05.1980. Me vendim nr. {...}, datë 12.11.1993 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe më pas është dekretuar me dekretin nr. {...}, datë 06.03.2000.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e mësipërm nr.178, datë 11.05.2022, rezulton të ketë mbi 28 (njëzet e tetë) vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati rezulton që deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e mësipërm, kandidati ka një përvojë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale.

Në verifikimet që lidhen me kriterin e "mospasjes masë disiplinore në fuqi", nga verifikimet e bëra nuk rezulton që kandidiati të ketë masë disiplinore në fuqi.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, në lidhje me "papajtueshmërinë ambientale", nga verifikimet e bëra dhe deklaratën e dhënë nga kandidati, nuk rezulton që të kemi pengesë në këtë kriterin e fundit.

Ndodhur në këto kushte, ne si Komision i propozojmë Këshillit shqyrtimin përkatës dhe miratimin e projektvendimit i cili përbëhet gjithsej nga 3 pika.

Pika e parë është - Verifikimin e plotësimit nga kandidati të kritereve për ngritjen në detyrë. Pika e dytë - Vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore. Pika e tretë – Arsyetimi dhe një kopje e tij i njoftohet kandidatit sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit; dhe ky vendim hyn në fuqi dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022, të kritereve të "përvojës profesionale minimale", të "mospasjes masë disiplinore në fuqi" dhe të "mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale".

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.11.2022)

***Pika 5 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).[5]

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:43 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***

[5] Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej si pikë e tretë në rendin e ditës.

7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

4. Maela Alicanaj, Elisa Stamo, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Të tjerë: Katerina Çela, (Universiteti "Epoka"), Vladimir Karaj (BIRN).

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës, që ka të bëjë me verifikimin e plotësimit të kushteve për kandidatin z. {...}. Sërish relator është zoti Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Atëherë, për zotin {...} është e njëjta situatë. Kemi bërë verifikimet për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve.

Nga të gjitha verifikimet na rezultoi që nuk ekziston asnjë pengesë ligjore referuar tre kritereve, pra kriterit të "përvojës profesionale dhe përvojës specifike profesionale", që është plotësuar nga zoti {...}; njëkohësisht edhe për sa i përket kritereve të tjera, qenies pa masë disiplinore si dhe kriterit të papajtueshmërisë ambientale.

Në të gjitha verifikimet që kemi bërë ka rezultuar që zoti {...} nuk ka asnjë lloj pengese për të vijuar më tej kandidimin në lidhje me verifikimin e kritereve të tjera.

Ndodhur në këto kushte, ne propozojmë Komisionit projektvendimin përkatës i cili përbëhet nga tre pika, që unë i përmenda në rastin e zotit {...}, pra janë të njëjtat pika që përbëjnë projektvendimin përkatës. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Nëse nuk keni ndonjë diskutim mbi projekt-aktin e propozuar, kalojmë në votimin e tij.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022, të kritereve të "përvojës profesionale minimale", të "mospasjes masë disiplinore në fuqi" dhe të "mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale".

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pas trajtimit të kësaj çështjeje, anëtarët e Këshillit bëjnë 2 minuta pushim, për të vijuar mbledhjen me shqyrtimin e tre çështjeve të cilat trajtohen vetëm në prezencën e tyre.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.11.2022)

***Pika 9 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).[6]

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:43 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***

[6] Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej si pikë e katërt në rendin e ditës.

7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

4. Maela Alicanaj, Elisa Stamo, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Të tjerë: Katerina Çela, (Universiteti "Epoka"), Vladimir Karaj (BIRN).

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Atëherë, vijojmë rendin e ditës, pasi nga ana e Këshillit u shqyrtuan tre çështje për të cilat kërkohej vendimmarrje me dyer të mbyllura.

Kështu që, vijojmë me rendin e ditës me shqyrtimin e projektvendimit për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Komisioni paraqet sot përpara Këshillit relacionin për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kritereve ligjore të kandidimit të gjyqtarit në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve, të z. {...}.

Në tre kriteret e kandidimit ne kemi bërë verifikimet përkatëse dhe ka rezultuar se për zotin {...} është bërë verifikimi i kriterit të përvojës profesionale.

Me vendimin e Këshillit nr. 178, datë 11.05.2022 është hapur vendi për një anëtar në Gjykatën e Lartë.

Sipas informacioneve që ne kemi marrë për tre kriteret ka rezultuar se zoti {...} ka marrë titullin "Jurist" pranë Universitetit të Tiranës, më datë 07.07.2000. Më pas, me dekretin nr. {...}, datë 21.10.2003 të Presidentit të Republikës ai caktohet të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin nr. {...}, datë 16.09.2004 të Presidentit të Republikës caktohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Me vendim nr. {...}, datë 02.06.2010 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë delegohet për të kryer përkohësisht detyrën e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, funksion të cilin e ka ushtruar deri më datë 23.07.2014. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit si magjistrat është 19 vite.

Njëkohësisht, referuar edhe përvojës specifike profesionale ka rezultuar, sipas urdhrave respektivë të kryetarëve të gjykatës, se prej vitit 2004 - dhjetor 2010 ka qenë pjesë e seksionit civil; prej janarit 2011 – dhjetor 2014 z. {...} ka qenë pjesë e seksionit penal në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier; prej korrikut 2019 e në vijim ka qenë anëtar i seksionit penal, duke gjykuar edhe çështjet në seksionin e të miturve.

Rrjedhimisht rezulton nga të dhënat dhe dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr.178, datë 11.05.2022, të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale.

U verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore”, dhe rezulton që nuk ka masë disiplinore nga të dhënat e grumbulluara/të mbledhura dhe të verifikuara nga Komisioni.

Njëkohësisht u verifikua edhe kriteri i papajtueshmërisë ambientale. Rezultoi që nga verifikimet e bëra, kandidati nuk ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale nëse ai do të vijonte më tej kandidimin për vendin e lirë të shpallur në Gjykatën e Lartë.

Ndodhur në këto kushte, për sa kohë të tre kriteret formale të kandidimit janë të verifikuara, ne paraqesim projektvendimin përkatës i cili përbëhet nga tre pika që janë integruar në këtë projektvendim. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, ftoj kolegët, nëse nuk kanë diskutime, të kalojmë në miratimin e projekt-aktit sipas propozimit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.11.2022)

***Pika 10 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për mbarimin e statusit të magjistratit për znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Klodian Kurushi).[7]

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:43 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

12. Naureda Llagami	***(kryetare)***
13. Ilir Rusi	***(zëvendëskryetar)***
14. Klodian Kurushi	***(anëtar)***
15. Fatmira Luli	***(anëtare)***
16. Irena Plaku	***(anëtare)***
17. Dritan Hallunaj	***(anëtar)***
18. Ridvan Hado	***(anëtar)***
19. Alban Toro	***(anëtar)***
20. Marçela Shehu	***(anëtar)***

[7] Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej si pikë e pestë në rendin e ditës.

21. Brikena Ukperaj ***(anëtare)***

22. Yllka Rupa ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

4. Maela Alicanaj, Elisa Stamo, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Të tjerë: Katerina Çela, (Universiteti "Epoka"), Vladimir Karaj (BIRN).

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit "Për mbarimin e statusit të magjistratit për znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren znj. {...}.

Për më shumë detaje ia jap fjalën zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar kolegë, paraqesim relacionin e radhës që ka për objekt projektvendimin "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren znj. {...}".

Zonja {...} është me statusin e magjistratit.

Me dekretin nr. {...}, datë 25.06.2010 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Me vendim nr. 453, datë 19.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor komandohet në pozicionin "Nëpunës përgjegjës për vlerësimin" në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një periudhë 2 (dy) vjeçare.

Me vendim nr. 575, datë 07.12.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor miratohet kërkesa për dhënie leje të papaguar për arsye familjare, për një periudhë 1 (një) vjeçare, nga data 24.12.2021 deri më datë 24.12.2022.

Me vendim nr. 432, datë 18.10.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet përfundimi i komandimit në pozicionin "Nëpunës përgjegjës për vlerësimin" në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të saj si magjistratë është 13 vjet dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Zonja {...} ka paraqitur një kërkesë në Këshillin e Lartë Gjyqësor ku ka parashtruar edhe motivin për heqjen dorë nga statusi i magjistratit, duke argumentuar ndër të tjera se: "...Duke qenë në përfundim të lejes dhe për shkak se në gusht të vitit 2022 kam filluar studimet Master në Pronësi Intelektuale pranë Chicago Kent College of Law, Illinois, US, dhe në vijim do të aplikoj për OPT duke ndjekur një tjetër mundësi në lidhje me aspektin profesional, në bazë të Nenit 64/1(a) dhe nenit 65 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", kërkoj dorëheqjen nga funksioni dhe mbarimin e statusit si magjistrate.".

Propozimi i Komisionit – Referuar nenit 65 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar i cili përcakton se: "1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. 3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni".

Ndodhur në këto kushte, ne bëjmë propozimin tonë përkatës. Bashkëlidhur relacionit është edhe projektvendimi, i cili është i strukturuar në katër pika.

Në pikën e parë parashikohet deklarimi i mbarimit të statusit për znj. {...}, për shkak të dorëheqjes.

Në pikën e dytë parashikohen efektet juridike të këtij vendimi sipas nenit 65/2 të ligjit "Për statusin", i ndryshuar. Efektet fillojnë nga data 30.11.2022.

Në pikën e tretë parashikohet se një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Në pikën katër parashikohet e drejta e ankimit - Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Gjithashtu është parashikuar edhe hyrja në fuqi dhe publikimi, me këtë formulim: Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim, të kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro. Në fakt, nuk kemi zgjidhje tjetër përveçse miratimit, sepse është vendim deklarativ i Këshillit, por nuk mund të rri pa i thënë dy fjalë për zonjën {...}. Në fakt, do ta quaja veten me fat që kam punuar me Zetën edhe në gjykatën e shkallës së parë në Lushnjë, edhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor si pjesë e nëpunësve përgjegjëse për vlerësimin, ku ka treguar një shkallë shumë të lartë integriteti personal

dhe profesional dhe mendoj që ajo të njëjtin sukses do të ketë edhe në fushën akademike, të cilën ajo ka zgjedhur të vazhdojë. Në fakt nuk është humbje për {...}, është humbje për sistemin. Por besoj që ajo e ka menduar shumë mirë, është zgjedhje e saj. Unë doja t'i uroja suksese. Faleminderit!

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, për shkak të dorëheqjes së saj.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 30.11.2022.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.11.2022)

***Pika 11 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për dërgimin e emrit të kandidatit i cili ka aplikuar për t'u komanduar, në pozicionin "Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit" në Ministrinë e Drejtësisë", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:43 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***

10. Brikena Ukperaj ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

4. Maela Alicanaj, Elisa Stamo, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Të tjerë: Katerina Çela, (Universiteti "Epoka"), Vladimir Karaj (BIRN).

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit "Për dërgimin e emrit të kandidatit i cili ka aplikuar për t'u komanduar, në pozicionin "Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit" në Ministrinë e Drejtësisë", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për dërgimin e emrit të kandidatit i cili ka aplikuar për t'u komanduar, në pozicionin "Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit" në Ministrinë e Drejtësisë", projekt-akt i cili do të relatohet nga zoti Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Bashkëlidhur projektvendimit që kemi dërguar për t'i dërguar Ministrisë së Drejtësisë emrin e zotit Demollari i cili është aplikanti i vetëm në thirrjen e hapur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për t'u përfshirë në skemën e komandimit të kërkuar nga Ministria e Drejtësisë.

Pas fazës së parë kemi mbledhur të gjithë kërkesat e kandidatëve. Ka rezultuar që ekziston vetëm një kandidat i vetëm, i cili ka aplikuar për t'u përfshirë në skemën e komandimit dhe ai është z. {...}. Brenda dy javëve është paraqitur dokumentacioni përkatës.

Vlerësimi i Komisionit – Në vlerësimin tonë plotësohen të gjitha kushtet dhe kriteret të cilat ne i kemi përcaktuar në vendimin e parë në kohën kur kemi hapur pozicionin e lirë për të kandiduar në skemën e komandimit.

Në rastin konkret, vetëm zoti Demollari është kandidat i vetëm.

Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, ai ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli "Jurist", pranë Universitetit "Luarasi" në datë 03.07.2013, ka përfunduar studimet Master i Shkencave Juridike, në profilin "E drejtë penale" në Universitetin "Luarasi" në datë 16.07.2015 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019. Me vendim nr. {...}, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendim nr. {...}, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, ku dhe aktualisht ai vazhdon të ushtrojë detyrën. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 2 vite.

Në këto kushte, për këtë gjyqtar nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës, rezulton që: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka në organikën e saj 4 (katër) gjyqtarë dhe në detyrë janë 4 (katër) të tillë, por një nga ata është i transferuar përkohësisht në këtë gjykatë, z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Nga verifikimi i kryer nga ana e specialistit të IT-së në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIC i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, rezulton se ngarkesa e çështjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës më datë 08.11.2022 është si vijon: Kryetarja në detyrë ka çështje të gjykuara për vitin 2022 – 326; {...} – 334; zonja {...} – 9

sepse është gjyqtare e re që ka filluar funksionet e saj si gjyqtare në fund të muajit korrik; zoti {...} – 243 çështje.

Sipas opinionit të zëvendëskryetares së gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, rezulton që ajo e ka lënë në vlerësim të Këshillit faktin nëse do të vijojmë më tej procedurat për komandimin e gjyqtarit apo jo.

Nga informacioni i marrë nga Departamenti i Shërbimeve Juridike rezulton se, në vitin 2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka paraqitur në total 7 kërkesa për caktim gjyqtari, në përgjigje të të cilave janë caktuar 7 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyre të përhershme.

Në kushtet e mësipërme, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se komandimi i z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës në pozicionin "Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit" në Ministrinë e Drejtësisë, përballë ngarkesës së çështjeve që ka kjo gjykatë dhe numrit aktual të gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën pranë kësaj gjykate, sikundër dhe pritshmërisë pozitive që do të sjellë zbatimi i hartës së re gjyqësore, nuk passjell (sipas vlerësimit tonë) cenim të interesave të larta të kësaj gjykate për sa kohë funksionaliteti i saj do të vijojë të ruhet.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor që të vendosë: T'i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë emri i z. {...}, i cili ka aplikuar për t'u komanduar, në pozicionin "Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit" në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe praktikën dokumentare të paraqitur prej tij.

Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. T'i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë emri i z. {...}, i cili ka aplikuar për t'u komanduar, në pozicionin "Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit" në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe praktikën dokumentare të paraqitur prej tij.

2. Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.11.2022)

***Pika 12 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).[8]

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:43 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***

[8] Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 13-ta në rendin e ditës.

10. Brikena Ukperaj ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

4. Maela Alicanaj, Elisa Stamo, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Të tjerë: Katerina Çela, (Universiteti "Epoka"), Vladimir Karaj (BIRN).

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj.)

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, znj. {...}". Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Atëherë, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar kërkesa nr. {...} prot., datë 09.11.2022 e gjyqtares {...}, me anë të cilës kërkon mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të mbushjes së moshës së detyruar për pension pleqërie.

Në arsyetimin e kërkesës gjyqtarja sqaron se plotëson kriteret ligjore për të gëzuar të drejtën e pensionit të parakohshëm. Ndërkohë, në përfundim të arsyetimit, duke ju referuar kërkimit të saj, thekson: "Në këto kushte paraqes kërkesën para Këshillit të Lartë Gjyqësor, për dorëheqjen time të parevokueshme nga statusi i magjistratit, duke kërkuar shqyrtimin e kërkesës dhe marrjen e vendimit për përfundimit e statusit të magjistratit, para mbarimit të mandatit të magjistratit."

Nisur nga konfuzioni mes objektit dhe përmbajtjes së kërkesës së sipërcituar, nga ana jonë është kërkuar saktësim i objektit të kërkesës nëse kërkonte mbarimin e statusit të magjistratit si pasojë e pensionit të parakohshëm, apo si pasojë e dorëheqjes, duke specifikuar edhe bazën ligjore mbi të cilën bën kërkimin.

Nga ana e saj znj. {...}, përmes aktit protokolluar me shkresën nr. {...} prot., datë 14.11.2022 është saktësuar objekti, ku thuhet: "Kërkoj të miratoni kërkesën për mbarimin e statusit të magjistratit, si pasojë e dorëheqjes, për arsye të daljes në pension pleqërie si grua dhe për shkak të gjendjes së renduar shëndetësore në të cilën ndodhem".

Gjithashtu ajo ka specifikuar edhe bazën ligjore, përkatësisht nenet 64/1 germa "a" dhe 65 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, pra ka saktësuar objektin e kërkesës e cila kërkon dorëheqjen.

Referuar të dhënave të administruara nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative rezulton se: znj. {...} ka përfunduar studimet në drejtësi, titulli "Jurist", pranë Universitetit të Tiranës në datë 29.05.1982.

Me vendim nr. 13, datë 24.11.1993 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ku dhe aktualisht ushtron detyrën. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 28 vite.

Ndërkohë, referuar informacioneve lidhur me nisjen e procedimeve disiplinore dhe/apo masave disiplinore gjate karrierës së saj, rezulton që:

Me vendim nr. 558/2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është caktuar masa disiplinore "Ulje e përkohshme e pagës në masën 20%, për një periudhë 6-mujore".

Me vendim nr. {...} Këshilli i Lartë i Drejtësisë pezullon përkohësisht nga

ushtrimi i detyrës gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Znj. {...}, deri në përfundim të procedimit penal në ngarkim të saj.

Pastaj është e gjithë ecuria e të gjitha kërkesave të saj apo procedimeve disiplinore që ajo ka pasur.

Sipas parashikimit ligjor të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 64, thuhet shprehimisht që kohëzgjatja në detyrë e magjistratit mbaron kur: a) jep dorëheqjen; b) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë...", etj.

Neni 65. Dorëheqja - "Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës...".

Referuar ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, neni 97 - Aktet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili në ushtrim të funksioneve nxjerr akte: a) akte administrative individuale, etj. Neni 98 - Njoftimi dhe botimi.

Në referim të nenit 65 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", parashikohet që: "1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.

Në këto kushte kemi përgatitur edhe projektvendimi, ku sipas pikës së parë kemi: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak të dorëheqjes së saj nga ky status.

Sipas pikës së dytë, fillimin e efekteve më datë 31.12.2022.

Sipas pikës së tretë, parashikimin që një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Së katërti parashikohet e drejta e ankimit ndaj vendimit të subjektit, brenda afatit 15-ditor nga njoftimi i vendimit.

Dua të shpreh edhe unë dy fjalë në lidhje me sa... për efektin e dorëheqjes. Pra ka paraqitur dorëheqjen por kemi kërkuar specifikimin nëse dorëheqja është për efekt të moshës dhe në fund është specifikuar/saktësuar që ka dorëheqje.

Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Hallunaj lidhur me relatimin e projekt-aktit.

Ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim.

Nëse jo, kalojmë në miratimin e tij.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak të dorëheqjes së saj.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 31.12.2022.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.11.2022)

***Pika 13 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, "Për caktimin e gjyqtarëve për mediat", i ndryshuar", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu). [9]

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:43 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***

[9] Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 12-ta në rendin e ditës.

9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

4. Maela Alicanaj, Elisa Stamo, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Të tjerë: Katerina Çela, (Universiteti "Epoka"), Vladimir Karaj (BIRN).

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i projektvendimit "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, "Për caktimin e gjyqtarëve për mediat", i ndryshuar", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i fundit për mbledhjen e sotme që ka të bëjë me një ndryshim në vendimin e Këshillit lidhur me caktimin e gjyqtarëve për mediat. Për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Shehu, e cila anëtarja e caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Marçela Shehu: Faleminderit Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 91, pika 3 e Ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", me vendimin nr. 280, datë 10.12.2019, të ndryshuar me vendimin nr. 292, datë 06.07.2021; me vendimin nr. 424, datë 29.09.2021 dhe me vendimin nr. 254, datë 07.07.2022, ka vendosur caktimin e gjyqtarëve, si më poshtë, në pozicionin e Gjyqtarit për Mediat për çdo juridiksion apeli:

{...} - juridiksioni i apelit Shkodër

{...} - juridiksioni i apelit Tiranë

{...} - juridiksioni i apelit Durrës

{...} - juridiksioni i apelit Vlorë

{...} - juridiksioni i apelit Korçë

{...} - juridiksioni i apelit Gjirokastër

{...} - juridiksioni i apelit Administrativ

{...} - juridiksioni për gjykimin e veprave penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Gjyqtari {...}, i caktuar si Gjyqtar për Median në juridiksionin e Apelit Durrës ishte një ndër kandidatët për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura nga Këshilli.

Në vijim, pas përmbylljes së procedurës së përzgjedhjes, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e tij nr. 119, datë 01.04.2021 për ngritje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 445, datë 01.11.2022, ka vendosur:

"1. Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të z. {...}. 2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 06.11.2022..."

Sa më sipër, gjyqtari {...}, i caktuar si Gjyqtar për Median në juridiksionin e apelit Durrës nuk mund të ushtrojë më këtë funksion pranë kësaj gjykate.

Me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimit kushtetues për informimin e publikut në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, në zbatim të nenit 91 të ligjit nr. 115/2016 dhe vendimit nr. 590 datë 26.11.2020 "Për miratimin e Planit Strategjik të Komunikimit për sistemin

gjyqësor", të Këshillit, ka përgatitur projektvendimin "Për ndryshimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, "Për caktimin e Gjyqtarëve për Mediat", i ndryshuar".

Projektvendimi u hartua pas konsultimit me zëvendëskryetarin në detyrë dhe gjyqtarët që ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet ndryshimi i pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019 "Për caktimin e Gjyqtarëve për Mediat", duke zëvendësuar gjyqtarin për mediat në juridiksionin e apelit Durrës, z. {...}, me gjyqtarin z. {...}. Siç edhe u relatua pak më lart, ky propozim vjen edhe si propozim i vetë gjyqtarëve që aktualisht ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se ngarkohen Gjyqtari për Mediat i juridiksionit të apelit Durrës dhe gjykatat e shkallës së parë të marrin masat për zbatimin e këtij vendimi.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e menjëhershme e vendimit dhe botimi i tij faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit për relatimin e projekt-aktit.

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim. Nëse jo, kalojmë në votimin e tij.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Në pikën 1 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat” i ndryshuar me vendimin nr. 292, datë 06.07.2021; me vendimin nr. 424, datë 29.09.2021 dhe me vendimin nr. 254, datë 07.07.2022, gjyqtari për mediat e juridiksionit të apelit Durrës z. {...}, zëvendësohet në këtë detyrë nga gjyqtari z. {...}.

2. Ngarkohen Gjyqtari për Mediat i juridiksionit të apelit Durrës dhe gjykatat e shkallës së parë të marrin masat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë me kaq mbyllim çështjet që kishim sot për rendin e ditës.

Pasi u vumë në dijeni nga urgjencat që kanë ardhur për nevojën për caktimin e gjyqtarëve, për 30 minuta, pra në orën 14:45 do të mblidhemi për të diskutuar projekt-aktin që është bërë gati nga administrata mbi caktimin e gjyqtarëve në çështje të veçanta në gjykatat në nevojë.

Faleminderit!

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor